HEI'25
Higher Education Intervention 2025

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

INTEGRITETI AKADEMIK DHE PUBLIKIMI SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS



Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6

Autor i përmbajtjes:
Skord Retkoceri
Rron Gjinovci

Hartues i raportit:
Rron Gjinovci

Prishtinë, Shtator 2025

"Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s'kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit.
Ashtu qoftë!"

Faik Konica

Përmbajtja

5 **Përmbledhje ekzekutive**

8 **Të dhënat për universitetin**

7 **Publikimi shkencor**

10 Në cilat kuartale të Scopus-it publikuan stafi?

12 Vendet nga ku janë botuesit e revistave

15 Punimet e vlefshme për avancim

17 **Publikimi në revista dhe botues të dyshimtë**

18 **Justifikimi i titujve akademikë**

21 **Metodologjia**

Përmbledhje Ekzekutive

[Përmbledhja e gjeneruar nga ChatGPT]
"Gjenero një përmbledhje ekzekutive të raportit hulumtues të bashkangjitur, bazuar në të dhënat e paraqitura. (max. 350 fjalë)"

Raporti për Universitetin e Gjakovës analizon integritetin akademik dhe publikimin shkencor të stafit akademik, duke u mbështetur në të dhëna të përpunuara nga burime të verifikuara ndërkombëtare si Scopus dhe Web of Science. Universiteti ka gjithsej 69 anëtarë të stafit akademik, prej të cilëve 46 mbajnë tituj profesorialë dhe 23 janë asistentë. Përbërja gjinore është pothuajse e barabartë (36 burra dhe 33 gra), por shumica e grave janë ende në pozita asistente. Kjo sugjeron një potencial të madh për avancim të grave në vitet e ardhshme.

Në fushën e publikimit shkencor, stafi ka realizuar 167 punime të indeksuara, ku 130 janë vetëm në Scopus, 1 vetëm në Web of Science dhe 35 në të dy platformat. Kulmi i publikimeve është arritur në vitin 2023 me 40 punime, ndërsa trendi mbetet pozitiv që nga viti 2021, duke reflektuar ndikimin e Udhëzimit Administrativ të vitit 2018. Megjithatë, 10% e punimeve janë në revista të përjashtuara nga Scopus për probleme cilësie dhe 30% e stafit ka publikuar të paktën një herë në revista të botuesve të dyshimtë, çka mbetet sfidë për integritetin shkencor.

Analiza e kuartaleve të Scopus-it tregon se 37% e punimeve janë në Q3 dhe 22% në Q4, duke ngritur shqetësime për cilësinë e disa prej publikimeve. Megjithatë, 25 punime janë të indeksuara edhe në Web of Science, duke rritur kredibilitetin akademik të universitetit. Fakulteti i Mjekësisë dhe ai i Edukimit kanë prodhimin më të madh shkencor në numra absolutë, ndërsa Fakulteti i Shkencave Aplikative shquhet me mesataren më të lartë për anëtar stafi.

Në aspektin e justifikimit të titujve akademikë, për herë të parë në vitin 2025, shumica e profesorëve (59%) i justifikojnë titujt e tyre në bazë të punimeve të vlefshme. Interesant mbetet fakti që burrat (66%) performojnë më mirë se gratë (47%) në këtë drejtim, ndryshe nga trendi i universiteteve tjera publike.

Në përfundim, Universiteti i Gjakovës shfaq progres të qëndrueshëm në publikimin shkencor dhe në justifikimin e titujve akademikë, megjithëse mbeten sfida të lidhura me cilësinë e revistave dhe integritetin e botimeve. Ky progres duhet të konsolidohet me diversifikim të publikimeve dhe rritje të angazhimit akademik të të gjithë stafit.

Të dhëna për universitetin

Universiteti i Gjakovës ka gjithsejt 69 pjesëtarë të stafit akademik ku hyjnë 23 asistentë, 21 profesorë asistentë, 15 profesorë të asocuar dhe 10 profesorë të rregullt, pra 46 pjesëtarë të stafit akademik me tituj profesorialë dhe 23 asistentë. Numri më i madh i stafit akademik është në Fakultetin e Mjekësisë (24) ndërsa më i vogli në Fakultetin e Shkencave Aplikative (3).

Numri i stafit akademik sipas fakulteteve

	Profesorët e rregullt	Profesorët e asocuar	Profesorët asistentë	Asistentë	Total staf
Fakulteti i Mjekësisë	2	5	5	12	**24**
Fakulteti i Edukimit	3	6	5	5	**19**
Fakulteti i Filologjisë	3	2	7	5	**17**
Fakulteti i Shkencave Sociale	1	1	3	1	**6**
Fakulteti i Shkencave Aplikative	1	1	1	0	**3**
Të gjitha fakultetet	**10**	**15**	**21**	**23**	
	46				
	69				

Universiteti i Gjakovës ka 36 burra si pjesëtarë të stafit akademik dhe 33 gra, ndoshta i vetmi universitet publik ku numri i grave dhe burrave si pjesëtarë të stafit akademik është pothuajse i barabartë. Megjithatë ajo që vërehet është se gjysma e grave, 16 prej tyre janë asistente, pra në pozitë akademike pa titull profesorial, ndërsa 17 të tjera janë me tituj profesorialë, vetëm një nga to me titull të profesorit të rregullt (shkalla e fundit e titujve profesorialë).

Në anën tjetër, 29 burra kanë tituj profesorialë dhe vetëm 7 janë asistentë. 9 burra janë me titullin e profesorit të rregullt, ndërsa 8 si profesor të asocuar karrshi 7 grave profesore të asocuara. Kur vjen fjala te profesorët asistentë, burra që mbajnë këtë titull janë 12 ndërsa gra 8.


E te asistentët përmbysja në favor të grave është predominante me 16 asistente gra dhe 7 burra. Pasë parasysh mundësinë që gjatë proceseve avancuese, siç ndodh rëndom që asistentët marrin titullin e parë profesorial atë të profesorit asistent, mund të pritet që në një të ardhme 5-10 vjeçare numri më i madh i stafit akademik me tituj profesorial të jetë gra.

Përbërja e stafit sipas gjinisë

	Profesorët e rregullt	Profesorët e asocuar	Profesorët asistentë	Asistentë	**Total**	
Gra	1	7	9	16	33	**48%**
Burra	9	8	12	7	36	52%
Total	**10**	**15**	**21**	**23**	**69**	**100%**

Publikimi shkencor në Universitetin e Gjakovës

Stafi akademik (profesorët dhe asistentët) kanë publikuar 167 punime shkencore në revista të indeksuara në Scopus ose Web of Science. Prej tyre 131 janë të indeksuara vetëm në Scopus, 1 punim vetëm në Web of Science dhe 35 në të dyja. Këtu nuk përfshihen komunikimet e shkurta, 'case reports', letrat për redaksinë etj. Nuk janë përfshirë as punimet në revistat apo botues që janë të listuar si të dyshimtë.




Punimi i parë i evidentuar i një pjesëtari aktual të Universitetit të Gjakovës është i vitit 2010. Kulmi i produktit shkencor në këtë universitet është arritur në vitin 2023 kur janë publikuar 40 punime shkencore, 35 në revisa të indeksuara në platformën SCOPUS dhe 5 në Web of Science. Megjithatë, është për tu parë me optimizëm fakti që nga viti 2021 numri i publikimeve shkencore është mbi 20 çdo vit dhe në rritje të vazhdueshme.

Ky fenomen është vërejtur te të gjitha universitetet publike dhe ka të bëjë me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ të 1 janarit 2018. Ky udhëzim i cili ende është në fuqi ishte nënshkruar nga Ministri i atëhershëm Shyqiri Bytyqi. Ndonëse udhëzimi parashihte edhe 3 platforma tjera të listimit dhe indeksimit të revistave përveç Web of Science dhe SCOPUS, rregullativa e shumicës së universiteteve publike, e po ashtu ajo e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, njohin vetëm këto dy platforma.


Deri në shtator të vitit 2025, ky udhëzim nuk ka ndryshuar dhe shërben vetëm si standardi më i ulët mbi të cilin universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë mund të ndërtojnë rregullativën e tyre të publikimit akademik. *

Numri i punimeve shkencore në Universitetin e Gjakovës sipas viteve



Në grafikun sipër shihen numrat e publikimeve vit për vit, më poshtë jepet kumulativi i produktit shkencor të publikuar në revista të indeksuara në Web of Science dhe SCOPUS. Rritja e vazhdueshme dhe e shpejtë sidomos në 5 vitet e fundit është tregues i rritjes së përkushtimit nga stafi akademik i Universitetit të Gjakovës në këtë drejtim.

Rritja e publikimit shkencor në Universitetin e Gjakovës përgjatë viteve



Prej 166 punimeve të indeksuara në Scopus, 17 apo 10% janë nga revista të larguara nga Scopus në vite të ndryshme. Ky numër është i ngjashëm me universitete tjera publike, bie fjala ai i Pejës që ka 12%. 13 anëtarë të stafit, pra 19% e tyre kanë publikuar në revista të tilla. Revistat largohen nga Scopus nëse pas një rivlerësimi periodik vërehen probleme me cilësinë e përmbajtjes, mungesë të praktikave të besueshme editoriale apo shkelje të standardeve etike të publikimit.


Punime të publikuara në revista të përjashtuara nga Scopus për çështje cilësie

Revista ku ndodhen punimet	Viti i publikimit të punimit	Viti i fundit i indeksimit në Scopus
Open Açess Macedonian Journal of Medical Sciences	1 punim - 2016 3 punime - 2017 1 punim - 2019	2022
Fresenius Environmental Bulletin	1 punim - 2018	2021
Journal of Language and Linguistic Studies	1 punim - 2021	2021
Journal of Liberty and International Affairs	2 punime – 2021 1 punim - 2022 1 punim - 2023	2023
Journal of Pharmaceutical Negative Results	2 punime - 2022	2022
Acta Medica Mediterranea	2 punime - 2022	2023
European Journal of Contemporary Education	1 punim - 2023	2023
Educational Administration: Theory and Practice	1 punim – 2023	2023


Në cilat kuartale të SCOPUS-it publikuan stafi akademik i Universitetit të Gjakovës?

Kualiteti i revistave të indeksuara në Scopus, në të cilat publikon stafi akademik i universiteteve publike tregohet përmes rangimit të tyre në kuartale indeksimi. Kuartali i parë dhe i dytë garantojnë cilësi, ndërkaq i treti dhe i katërti nuk janë garantues të cilësisë meqë në të kaluarën vet ORCA ka adresuar probleme të praktikave të dyshimta të revistave të indeksuara në Scopus të cilat pas denoncimeve të ORCA-s ose janë larguar nga indeksimi në Scopus ose janë futur në listën e zezë të universiteteve publike.

Numri i publikimeve sipas kuartaleve në Scopus



37% e punimeve të publikuara në revista të indeksuara në SCOPUS, i përkasin indeksimit në kuartalin e e parë dhe të dytë. Ndërsa, 33 % e tyre janë vetëm në kuartalin e tretë dhe 22% të tjera në të kartëtin, që së bashku bëjnë 55% të punimeve. Kjo shtrirje e punimeve nëpër kuartale, e sidomos në të parin dhe të dytin është e kënaqshme dhe ulë mundësitë për përjashtim të revistave nga indeksimi në SCOPUS, çka është më e mundshme në revistat e kuartalit të kartët e ndonjëherë edhe të tretë.



Kuartalet dhe ndërlidhja me Web of Science

Rëndom, revistat e indeksuara në Scopus në kuartalet një dhe dy, janë të indeksuara edhe në Web of Science, çka e rritë garancinë e kualitetit të tyre të procesit "peer review". Mund të ndodhë që edhe revistat e e kuartalit të tretë të kenë indeksim në Web of Science, por ndodh rrallë apo fare që revistat e kuartalit të katërt. Si rrjedhojë edhe ndërprerja e indeksimit nga Scopus ndodh zakonisht me revistat e indeksuara në kuartalin e katërt.* Siç mund të vërehet nga të dhënat 22% të të gjitha punimeve të stafit akademik të Universitetit të Gjakovës të indeksuara në Scopus i takojnë kuartalit të katërt.

	Numri i punimeve në Scopus	Prej tyre në Web of Science
Kuartali 1	21	14
Kuartali 2	40	11
Kuartali 3	55	9
Kuartali 4	36	1
Pa kuartal*	14	0

* Punimet e larguara nga Scopus nuk janë në asnjë kuartal

Shtetet nga ku janë botuesit e revistave në të cilat ka publikuar stafi

Stafi akademik në këtë universitet ka publikuar në revista nga 32 shtete të ndryshme. 15% e punimeve janë në revista të një shteti të vetëm, pra në Poloni. Fokusi i publikimit në shtete dhe revista të caktuara është shenjë e bashkëpunimit të brendshëm të stafit në identifikimin dhe synimin për publikim në revista ku tashmë ndokush nga stafi ka publikuar.


Vendet nga ku janë botuesit e revistave

Shteti	Numri i punimeve	Përqindja
Polonia	20	12%
Zvicra	16	10%
Italia	13	8%
Maqedonia e Veriut	11	7%
Mbretëria e Bashkuar	11	7%
SHBA	10	6%
Turqia	9	5%
Gjermania	8	5%
Sllovakia	8	5%
Ukraina	8	5%
Holanda	7	4%
Rumania	7	4%
Bullgaria	4	2%
Kroacia	4	2%
India	3	2%
Irani	3	2%
Irlanda	3	2%
Mali i Zi	3	2%
Brazili	2	1%
Franca	2	1%

Vendet nga ku janë botuesit e revistave

Shteti	Numri i punimeve	Përqindja
Tajvani	2	1%
Belgjika	1	1%
Bosnja dhe Hercegovina	1	1%
Kanadaja	1	1%
Egjipti	1	1%
Hungaria	1	1%
Lituania	1	1%
Malezija	1	1%
Zelanda e Re	1	1%
Nigeria	1	1%
Pakistani	1	1%
Serbia	1	1%
Afrika e Jugut	1	1%
Koreja e Jugut	1	1%

10 shtetet prirëse nga ku janë revistat që kanë botuar stafi në Universitetin e Gjakovës



Revistat ku stafi ka publikuar më së shumti punime

	Emri i revistës	Numri i punimeve	Vendi	Kuartali në Scopus
1	Journal of Educational and Social Research	16	Poloni	Q3
2	Open Açess Macedonian Journal of Medical Sciences **(larguar nga SCOPUS në 2022)**	5	Maqedoni	-
3	International Journal of Environmental Research and Public Health	4	Zvicër	Q2
4	Journal of Liberty and International Affairs **(larguar nga SCOPUS)**	4	Poloni	-


10% e punimeve të stafit akademik të Universitetit të Gjakovës ndodhen në revistën Journal of Educational and Social Research. Revista u themelua në vitin 2011 me botues "Mediterranean Center of Social and Educational Research (MCSER)", i listuar si i dyshimtë nga Beal.

Nga viti 2017 deri 2019 si botues kishte De Gruyter, botues akademik kredibil me bazë në Gjermani. Sa ishte në këtë botues, në vitin 2018 u indeksua nga SCOPUS-i. Që nga viti 2019 publikohet nga botuesi 'Richtmann Publishing'. Koncentrimi i publikimit në revista të caktuara apo edhe shtete të caktuara mund të jetë rrezik për rangimin e universitetit në të ardhmen në platforma kombëtare dhe ndërkombëtare të rangimit.

Mundësia që një revistë ku mund të ketë koncentrim të madh publikimesh të përjashtohet nga indeksimi apo të përballet me ndonjë problem të ngjashëm, është reale dhe si rrjedhojë do të mund të shkaktojë probleme. Diversifikimi i publikimit nga stafi akademik i universiteteve publike rritë mundësinë për bashkëpunim dhe shkëmbim ndërkombëtar çka është një nga indikatorët e cilësisë së një universiteti në shekullin 21.*

Punimet e vlefshme për avancim

Prej 167 punimeve, 123 punime janë të publikuara në revista të indeksuara në Web of Science dhe SCOPUS dhe mund të përdoren për avancim akademik. Të gjitha janë të indeksuara në Scopus, 25 prej tyre (20%) janë edhe në Web of Science. Krahasuar me Universitetin e Pejës, Gjakova qëndron më mirë në përfshirjen edhe në Web of Science të punimeve në revista që janë të indeksuara në SCOPUS ku vetëm 13% të punimeve të vlefshme për avancim janë në revista të indeksuara edhe në SCOPUS edhe në Web of Science.



19 prej punimeve, apo 19% (shprehur në përqindje është ngjashëm me Universitetin e Pejës), kanë të dy, si autorin e parë ashtu edhe autorin korrespodent, nga stafi akademik i universitetit, që do të thotë se të dy mund t'i përdorin këto punime për avancim akademik.


9 nga 46 profesorë apo rreth 20% nuk e kanë asnjë punim të vlefshëm për avancim akademik, pra si autor i parë ose korrespodent. 8 prej tyre nuk figurojnë si autorë në asnjë punim shkencor, në çfarëdo radhe. I bie që 80% e stafit janë angazhuar në prodhim shkencor dhe kjo përbën një shtrirje të kënaqshme të prodhimit shkencor në rrethanat kosovare.

Megjithatë duhet synuar që çdo person me titull profesorial të ketë prapa vetes punë signifikante shkencore, çka do të përbënte zbatim të ligjeve dhe rregullave në fuqi. Parë nga një perspektivë statistikore, stafi i Fakultetit të Shkencave Aplikative prin me numër më të madh të punimeve për kokë profesori me 4.3 punime për profesor, por kjo e dhënë zbehet nëse shihet me kujdes numri i stafit akademik (profesorë dhe asistentë) në këtë fakultet, i cili ka vetëm 3 të tillë. Si rrjedhim, mund të thuhet që prijëtar në produkt shkencor është Fakulteti i Mjekësisë i cili me 24 pjesëtarë të stafit akademik ka 45 punime shkencore me një mesatare prej 1.9 punimesh për kokë stafi akademik.

Numri i punimeve të vlefshme për avancim akademik sipas fakulteteve

	Numri i stafit akademik	Numri i punimeve	Numri i punimeve për një anëtarë stafi
Fakulteti i Mjekësisë	24	45	1.9
Fakulteti i Edukimit	19	37	1.9
Fakulteti i Filologjisë	17	23	1.4
Fakulteti i Shkencave Sociale	6	8	1.3
Fakulteti i Shkencave Aplikative	3	13	4.3
Në nivel universiteti	**69**	**126***	**1.8**

*Ky numër në kuptim të këtij kapitulli nuk e tregon vlerën absolute të punimeve që ekzistojnë të publikuara i cili është 123 punime. Duke qenë se në 19 punime autorët janë kolegë në cilësinë e autorit të parë dhe korrespodent dhe të dy kanë të drejtë ta përdorin të njëjtin punim në avancim akademike, për më tepër 3 prej punimeve, autorët janë kolegë nga fakultete të ndryshme në cilësinë e autorit të parë dhe korrespodent, numri 126 nuk është vlerë absolute e punimeve por vlerë relative që tregon sa herë janë numëruar punimet për avancime. Në kapitullin e këtij raporti "Publikimi Shkencor" numri absolut i punimeve është 123 dhe paraqet numrin e publikimeve ekzistuese të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare. Ndërkaq numri 126 paraqet numrin e punimeve në raport me pozitat profesoriale.**




Publikimi në revista dhe botues të dyshimtë

Stafi akademik në Universitetin e Gjakovës ka publikuar 15 punime të listuara në revista nga botues të dyshimtë. Këto revista kanë qenë po ashtu të indeksuara në SCOPUS, njëra nga to është përjashtuar nga indeksimi në SCOPUS ne vitin 2016. Ndërsa njëri prej punimeve ishte në një revistë me botues të dyshimtë të indeksuar në Web of Science.

14 profesorë, apo 30%, kanë publikuar të paktën një herë në revistë nga botues të dyshimtë. Për krahasim, në Pejë 45% e stafit akademik kanë publikuar të paktën një herë në revistë me botues të dyshimtë.

Publikimi në revista dhe botues të dyshimtë përgjatë viteve në Universitetin e Gjakovës



Justifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Gjakovës

Në këtë kapitull shihet vetëm justifikimi i titujve profesorialë, pra profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent, në raport me numrin e nevojshme të punimeve shkencore për secilën kategori. Për asistentët kjo matje nuk mund të aplikohet pasi për ta nuk kërkohen punime shkencore me rastin e emërimit të tyre.*

59% e profesorëve të Universitetit të Gjakovës i justifikojnë titujt e tyre akademikë. Me përjashtim të Fakultetit të Shkencave Sociale, në të gjitha fakultetet, numri i profesorëve që justifikojnë titujt e tyre akademikë është më i madh se i atyre që nuk e bëjnë një gjë të tillë.

Duke qenë se numri i profesorëve është i vogël, çdo tentim për ta analizuar situatën është i zbehtë, meqë nuk mund të dihen rrethanat që çojnë në këta numra. Prandaj, në rastin e Universitetit të Gjakovës, në tabelën e mëposhtëm interpretimi do të jetë i lirë për lexuesin.

Justifikimi i titujve akademikë sipas fakulteteve dhe titujve akademikë


	Profesorët e rregullt		Profesorët e asocuar		Profesorët asistentë		Të gjithë profesorët	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Fakulteti i Edukimit	1	2	3	3	4	1	8 57%	6 43%
Fakulteti i Filologjisë	0	3	1	1	5	2	6 50%	6 50%
Fakulteti i Mjekësisë	2	0	3	2	4	1	9 75%	3 25%
Fakulteti i Shkencave Aplikative	1	0	0	1	1	0	2 67%	1 60%
Fakulteti i Shkencave Sociale	0	1	0	1	2	1	2 40%	3 60%
Të gjitha fakultetet	**4 40%**	**6 60%**	**7 47%**	**8 53%**	**16 76%**	**5 24%**	**27 59%**	**19 41%**

Justifikimi i titujve akademikë sipas gjinisë


Është me rëndësi të theksohet se Universiteti i Gjakovës është i vetmi universitet publik ku burrat i justifikojnë më shumë titujt sesa gratë. Në të gjitha matjet e deritashme të ORCA-s në universitetet publike del se gratë qëndrojnë më mirë në performancën që lidhet me integritetin akademik. Në rastin e Universitetit të Gjakovës 66% e burrave i justifikojnë titujt e tyre akademikë ndërsa vetëm 47% e grave arrijnë ta bëjnë një gjë të tillë.

	Profesorët e rregullt		Profesorët e asocuar		Profesorët asistentë		Të gjithë profesorët	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Gra	0	1	2	5	6	3	8 47%	9 53%
Burra	4	5	5	3	10	2	20 66%	9 34%
Total	**4**	**6**	**8**	**7**	**16**	**5**	**28 59%**	**18 41%**

47% e grave i justifikojnë titujt akademikë





59% e burrave i justifikojnë titujt akademikë




Viti 2025 shënon një sukses historik në Universitetin e Gjakovës për sa i përket justifikimit të titujve. Për herë të parë numri i atyre që justifikojnë titujt është më i madh se i atyre që nuk i justifikojnë titujt akademikë. Ky rezultat është i lidhur drejtpërdrejt me rritjen e numrit të punimeve shkencore në mënyrë konsistente në 5 vitet e fundit në këtë universitet.

Justifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Pejës përgjatë viteve






Përqindja e justifikimit të titujve në **Universitetin e Gjakovës**




Fakulteti i Edukimit




Fakulteti i Filologjisë



Fakulteti i Mjekësisë



Fakulteti i Shkencave Aplikative



Fakulteti i Shkencave Sociale



Metodologjia

Përzgjedhja e stafit akademik
Në muajin dhjetor të vitit 2024 është gjeneruar lista e stafit akademik për secilin fakultet nga uebfaqja zyrtare e Universitetit të Gjakovës. Në rastet kur anëtarët e stafit akademik janë paraqitur në më shumë se një fakultet, është përdorur lista e stafit akademik nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Mbledhja e punimeve shkencore
Mbledhja e punimeve shkencore
Gjatë muajit janar të vitit 2025, për secilin anëtar të stafit akademik (profesor i rregullt, i asocuar, asistent dhe ligjërues), është krijuar një databazë me punimet shkencore:

- Nëse anëtari i stafit kishte profil në Google Scholar, janë marrë të gjitha punimet nga ky profil.
- Nëse nuk kishte profil, është bërë kërkim me emër në Google Scholar dhe janë përzgjedhur 50 punimet e para për secilin.

Përpunimi i të dhënave bibliografike
Për çdo punim janë evidentuar dhe analizuar këto të dhëna:

- Titulli i punimit, autorët, viti i publikimit, emri i revistës, identifikuesi unik (DOI), botuesi dhe renditja e autorit.
- Numrat ISSN të revistës dhe lloji i publikimit.
- Është kontrolluar nëse revista apo botuesi janë të listuar si të dyshimtë (sipas listës së Beall-it).

Verifikimi i indeksimit

- Është kontrolluar nëse revista ishte e indeksuar në Scopus në vitin e publikimit të punimit.
- Është verifikuar gjithashtu nëse revista bënte pjesë në një nga tre koleksionet kryesore të Web of Science: Science Citation Index Expanded (SCIE), Social Sciences Citation Index (SSCI) dhe Arts & Humanities Citation Index (AHCI).
- Janë shënuar rastet kur revista ishte larguar nga Scopus për arsye të cilësisë.

Përzgjedhja e punimeve të vlefshme
Janë konsideruar të vlefshme vetëm ato punime që:

- Janë artikuj shkencorë të botuar në revista që ishin të indeksuara në Scopus ose Web of Science në kohën e publikimit.
- Nuk janë publikuar në revista apo nga botues të dyshimtë.
- Nuk janë nga revista vendore
- Nuk janë komunikime të shkurta, ‘case reports’, letrat për redaksinë etj.

Analiza dhe kategorizimi
Është realizuar analizë sipas:

- Fakultetit, titullit akademik dhe gjinisë
- Është përllogaritur mesatarja e publikimeve për çdo anëtar të stafit.
- Është analizuar e vlefshmëria e punimeve për avancim akademik bazuar në rolin e autorit (i parë ose korrespodent) dhe nëse janë botuar në revista të indeksuara në Web of Science ose në Scopus në kohën e publikimit.

Analiza e justifikimit të titujve
Në analizën e justifikimit të titujve akademikë është aplikuar ky standard:

- **Profesor i rregullt:** të paktën 5 punime si autor i parë ose korrespodent.
- **Profesor i asocuar**: të paktën 3 punime si autor i parë ose korrespodent.
- **Profesor asistent:** të paktën 1 punim si autor i parë ose korrespodent.

***Shënim metodologjik mbi përsëritjen e tekstit**
Për nevoja të krahasimit dhe rangimit eventual të universiteteve publike, është përdorur metodolologjia dhe analizat e njëjta. Për këtë arsye disa pjesë të tekstit në këtë raport janë të njëjta me tekstet në raportet për universitetet tjera publike, pasi përshkruajnë, definicione, dukuri apo trende të ngjashme. Në të gjitha rastet ku në tekstin e mësipërm është përdorë teksti si në raportet e universiteteve tjera do të gjeni shënjimin “*” (asteriks).

Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

ORCA
organizata për mitjen e cilësisë në arsim